

LIGJ
Nr. 100/2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 49/2012, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE ADMINISTRATIVE DHE
GJYKIMIN E MOSMARRËVESHJEVE ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “a”, 83, pika 1, dhe 135, pika 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Numri i ndihmësve ligjorë për çdo gjykatë administrative caktohet nga Ministri i Drejtësisë, në varësi të ngarkesës së punës për çdo gjykatë. Në çdo rast, numri i tyre nuk mund të jetë më i vogël se 50 për qind e numrit të gjyqtarëve të kësaj gjykate. Gjyqtari i gjykatës administrative ka deri në dy ndihmës ligjorë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Procesi i përzgjedhjes së ndihmësit ligjor i nënshtrohet një procedure konkurruese rekrutimi, transparente dhe merite, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 2

Pas nenit 6 shtohen nenet 6/1, 6/2, 6/3, 6/4 dhe 6/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra

1. Ndhmësi ligjor emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të kryetarit të gjykatës, me propozimin e kancelarit gjykatës.

Kancelari i gjykatës përzgjedh dhe propozon për emërim ndihmësin ligjor nga lista e kandidatëve fitues, e shpallur nga komisioni *ad hoc*, sipas parashikimeve të nenit 6/4, të këtij ligji.

2. Propozohen dhe emërohen pa iu nënshtroar procedurave të konkurrimit kandidatët për ndihmës ligjorë, të cilët:

- a) kanë përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës;
- b) kanë punuar si gjyqtarë dhe nuk janë larguar nga sistemi për shkak të ndonjë mase disiplinore;
- c) kanë punuar si këshilltarë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, me përvojë pune në këto pozicione jo më pak se 5 vjet.

3. Propozimi i kancelarit të gjykatës për lirim dhe shkarkimin nga detyra të ndihmësit ligjor shoqërohet me mendimin me shkrim të gjyqtarit përkatës, pranë të cilit ai ushtron detyrën.

4. Ndhmësi ligjor shkarkohet nga detyra për:

- a) kryerjen e një vepre penale;
- b) paaftësi mendore a fizike;

- c) akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën, figurën e tij, imazhin e sistemit gjyqësor dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor;
 - ç) pamjaftueshmëri profesionale;
 - d) mospërbushje të detyrave të ngarkuara në mënyrë të përsëritur;
 - dh) mosrespektim në mënyrë të përsëritur të afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda;
 - e) moszbatim haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;
 - ë) braktisje të punës ose mungesë në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 7 (shtatë) ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit;
 - f) përfitim në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës;
 - g) shkelje në mënyrë të përsëritur të rregullave të etikës.
5. Kur shkarkimi nga detyra është bërë në shkelje të parashikimeve të këtij ligji, ndihmësi ligjor ka të drejtën e ankimit në gjykatën administrative të rrethit gjyqësor më të afërt dhe të shpërblimit të dëmit deri në shumën e pagës vjetore.

Neni 6/2

Paga e ndihmësit ligjor

1. Ndihmësi ligjor që ushtron veprimtarinë e tij pranë gjykatës së shkallës së parë përfiton përkatësisht pagën në vlerën 75 për qind të pagës së gjyqtarit të kësaj gjykate. Pas 5 vitesh vjetërsie në këtë detyrë, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.
2. Ndihmësi ligjor që ushtron veprimtarinë e tij pranë gjykatës së apelit përfiton përkatësisht pagën në vlerën 75 për qind të pagës së gjyqtarit të kësaj gjykate. Pas 5 vitesh vjetërsie në këtë detyrë, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit, por jo më shumë se paga e gjyqtarit të kësaj gjykate.

Neni 6/3

Kushtet për emërim

- Ndihmës ligjor mund të zgjidhet shtetasi shqiptar, që përmbush këto kushte:
- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - c) të jetë diplomuar si “Jurist”, sipas legjislacionit për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë në një nga fakultetet e drejtësisë, publike apo jopublike, të akredituara, brenda ose jashtë vendit;
 - ç) të ketë përvojë profesionale si jurist në organet e sistemit të drejtësisë, në funksione publike në administratën e Kuvendit, administratën e institucionit të Presidentit, aparatin e Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë, në Prokurori, si avokat apo si personel akademik i Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, si më poshtë:
 - i) mbi 5 vjet përvojë pune për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatën e shkallës së parë;
 - ii) mbi 7 vjet përvojë pune për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatën e apelit;
 - d) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - dh) të mos jetë i dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) të zotërojë të paktën një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 6/4

Shpallja e vendit vakant

1. Kryetari i gjykatës i komunikon strukturës përgjegjëse për administratën e gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë vendet e lira për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatë, të cilat duhet të shpallen për konkurs të hapur.

2. Struktura përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit për vendet vakante, shpall datën e konkurrimit të hapur në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

3. Ministri i Drejtësisë përcakton kriteret dhe procedurat e organizimit të testimit.

4. Kandidatët e interesuar për t'u emëruar ndihmës ligjorë paraqesin kërkesën pranë komisionit *ad hoc*, sipas njoftimit të shpallur për vendin vakant.

5. Komisioni *ad hoc*, pasi shqyrton të gjitha kërkesat, verifikon përmbushjen e kriterëve ligjorë, të parashikuara nga neni 6/3, i këtij ligji, për të vijuar procesin e testimit dhe shpall listën e konkurrentëve për pjesëmarrjen në konkurrim.

6. Komisioni *ad hoc* organizon dhe zhvillon testimin seleksionues dhe në përfundim të tij publikon rezultatet, në përputhje me rregullat e përcaktuara sipas pikës 3 të këtij neni.

7. Konsiderohen që kanë kaluar me sukses testimin seleksionues kandidatët që marrin jo më pak se 70 për qind të totalit të pikëve.

8. Komisioni *ad hoc* rendit në mënyrë përfundimtare kandidatët fitues, sipas numrit të pikëve të marra, dhe listën ia dërgon gjykatës përkatëse. Lista nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

9. Në rast se numri i kandidatëve fitues, sipas këtij neni, është më i madh se numri i vendeve të lira të shpallura, të dhënat për kandidatët e tjerë mbahen në një listë pritjeje, pa qenë e nevojshme kryerja e një testimi tjetër seleksionues, në rastet e krijimit të një vendi vakant. Lista e pritjes vlen për një periudhë jo më të gjatë se 2 vjet.

Neni 6/5

Komisioni *ad hoc*

1. Komisioni *ad hoc* ka në përbërje:

- a) kryetarin e gjykatës ku janë shpallur vendet vakante;
- b) një gjyqtar të asaj gjykate;
- c) kancelarin e asaj gjykate;
- ç) një përfaqësues të strukturës përgjegjëse për administratën gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;
- d) një pedagog të së drejtës administrative në institucionet e arsimit të lartë me gradë shkencore jo më të ulët se “Doktor”;
- dh) dy pedagogë të Shkollës së Magjistraturës.

2. Rregulla më të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e komisionit *ad hoc* përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

3. Anëtari i komisionit *ad hoc*, i përcaktuar në shkronjat “d” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, përfiton shpërblim për pjesëmarrje, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Në nenin 12, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet që në gjykatën e shkallës së parë gjykohen nga 1 gjyqtar, si dhe çështjet që kanë për objekt mosmarrëveshjet e kompetencave. Çështjet e tjera gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë.”.

Neni 4

Në nenin 49, pika 2, pas fjalëve “Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht” shtohen fjalët “sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë”.

Neni 5

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 52

Njoftimi për gjykim në apelin administrativ

Njoftimi për gjykimin në apelin administrativ bëhet sipas rregullave procedurale që zbatohen në gjykimin civil në Gjykatë të Apelit.”.

Neni 6

Në nenin 61, pika 2, hiqen fjalët “sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë dhe”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 31.7.2014